



# GRAFIATO

Ngjyra	Paketimi	Granulati	Konsumi
Bardhë	Thes 25 kg	1V	12 m <sup>2</sup> /thes
		1.5R, 1.5V	8-9m <sup>2</sup> /thes
		2V, 2R	7.5-8m <sup>2</sup> /thes
		3R	6.5-7 m <sup>2</sup> /thes



## PËRSHKRIM

Veshje dekorative për ambiente të jashtme dhe të brendshme me bazë çimento të bardhë. Material në formë pluhuri i përbërë nga rërë mermeri e cilësisë së lartë, aditivë special, agjentë hidrofobikë dhe gëlqere të hidratuar. Karakterizohet nga një punueshmëri shumë e mirë, kohë e gjatë pune, aplikim i shpejtë duke krijuar një strukturë të bukur dhe të njëtrajtshme. Është e rekomandueshme që shtresa e grafiatos të lyhet me bojë. Ofron rezistencë të lartë ndaj kushteve atmosferike, difuzion të mirë të avujve dhe veti kundër lagështirës

## FUSHA E APLIKIMIT

Aplikohet mbi suvanë mbushëse me bazë çimento-gëlqere. Të gjitha tipet e bazamenteve trajtohen më parë me rrafshuesin ECOLINER /BONDEX. E përshtatshme si veshje përfundimtare dhe për sistemet e termoizolimit.

## PËRGATITJA E BAZAMENTIT

Bazamenti duhet të jetë i pastër pa pluhura, vajra apo mbetje të cilat bëhen pengesë në lidhjen midis shtresave. Pastrimi i bazamentit bëhet në mënyrë mekanike. Përpara aplikimit të produktit është e nevojshme të bëhet nivelimi i të gjitha tipeve të bazamentit me rrafshuesin ECOLINER dhe të lyhet sipërfaqja me ASTARIN E GRAFIATOS Dekoll.



## APLIKIMI

Përziemi me një përzierës elektrik në një enë të paster me ujë produktin, derisa të arrihet një masë homogjene. Aplikoni produktin me një mallë të drejtë metalike. Më pas bëhet rrafshimi me një mallë plastike në drejtim vertikal, horizontal ose rrethor, gjithmonë në varësi të tipit të strukturës që duam të krijojmë. Pas-troni veglat e punes pas përfundimit të punës. Temperaturat optimale të punimit janë nga 5°C deri në 35°C.



### TË DHËNAT TEKNIKE

Pamja:	Pluhur
Paketimi:	Thes letre 25 kg në paleta 1350 kg
Ngjyra:	Bardhë
Kokrrizimi:	1, 1.5, 2, 3 mm
Magazinimi:	Të ruhet në vende të thata mbi paleta druri
Koha e magazinimit:	12 muaj nga data e prodhimit
Trashësia e aplikimit:	Maksimumi sa granula më e madhe
Ujë për përzierjen:	6 litra ujë për 25 kg
Temperatura e aplikimit:	+5°C deri në +35°C
Rezistenca në ngjeshje	5.1 N/mm <sup>2</sup>
Rezistenca në përkulje:	0.6 N/mm <sup>2</sup>
pH i përzierjes:	13
Reaksioni ndaj zjarrit:	Klasa A1
Absorbimi i ujit:	Kategoria W1
Konsumi:	
Grafiato 1 mm, strukturë e plotë:	12 m <sup>2</sup> /thes
Grafiato 1.5 mm, strukturë e plotë:	8-9 m <sup>2</sup> /thes
Grafiato 2 mm, strukturë e plotë:	7.5-8 m <sup>2</sup> /thes
Grafiato 3 mm, strukturë e plotë:	6.5-7 m <sup>2</sup> /thes
Konduktiviteti termik:	0.52W/mK